

**RELACION SHPJEGUES**  
**PËR PROJEKTVENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE**  
**“PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E PËRFSHIRJES SË ORGANIZATAVE TË**  
**SHOQËRISË CIVILE NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË KUJDESIT**  
**ALTERNATIV NË FAMILJE”**

**I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Përfshirja e organizatave të shoqërisë civile (OSHC) në sistemin e kujdesit alternativ në familje përbën një element strategjik të modelit të integruar të mbrojtjes së fëmijëve në Republikën e Shqipërisë. Organizatat e shoqërisë civile sjellin ekspertizë të dëshmuar, kapacitete profesionale të specializuara, përvojë në punën me grupe vulnerabël të fëmijëve dhe familjeve, si dhe një praktikë të gjatë në fushat e identifikimit, ndërgjegjësimit, rekrutimit, përgatitjes dhe mbështetjes së vazhdueshme të familjeve kujdestare. Pjesëmarrja e tyre është thelbësore për ndërtimin e një rrjeti kombëtar të qëndrueshëm të familjeve kujdestare dhe për ofrimin e shërbimeve cilësore mbështetëse.

Ligji nr. 92/2025 “Për kujdesin alternativ në familje në Republikën e Shqipërisë” njeh shprehimisht rolin e organizatave të shoqërisë civile në mbështetjen dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit alternativ në familje, duke ngarkuar Këshillin e Ministrave me detyrimin e miratimit të një akti nënligjor për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të përfshirjes së tyre. Aktualisht, mungesa e një kuadri të qartë rregullator për kriteret e cilësisë, procedurat e përzgjedhjes dhe mekanizmat e bashkëpunimit institucional pengon zhvillimin e plotë të potencialit të sektorit jopublik dhe krijon praktika të pa-uniformuara mes njësisë të vetëqeverisjes vendore.

Projektvendimi ka si qëllim përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe mënyrës së përfshirjes së organizatave të shoqërisë civile në mbështetjen dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit alternativ në familje, me qëllim garantimin e cilësisë së shërbimeve dhe mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijës. Për këtë qëllim, projektvendimi përcakton fushat e përfshirjes, kriteret ligjore, profesionale, organizative, financiare, të integritetit dhe sigurisë, procedurat e përzgjedhjes dhe kontraktimit, rolet e strukturave përgjegjëse, si dhe mekanizmat e monitorimit dhe raportimit.

Nëpërmjet këtij projektvendimi synohet:

- përcaktimi i fushave konkrete ku organizatat e shoqërisë civile mund të kontribuojnë në sistemin e kujdesit alternativ në familje, përfshirë identifikimin, promovimin, rekrutimin, përgatitjen, trajnimin dhe mbështetjen e vazhdueshme të familjeve kujdestare, si dhe mbështetjen e bashkive në proceset e monitorimit dhe vlerësimit të vendosjes;

- vendosja e një kuadri rregullator, transparent dhe konkurrues që siguron pjesëmarrje të barabartë dhe pa diskriminim të të gjitha subjekteve jopublike që plotësojnë kriteret e kërkuara;
- garantimi i cilësisë së shërbimeve të ofruara nga sektori jopublik përmes përcaktimit të kriterëve të rrepta ligjore, profesionale, organizative, financiare dhe të integritetit, si dhe nëpërmjet vlerësimit objektiv, mbi bazën e një sistemi pikëzimi me 100 pikë;
- mbrojtja e veçantë e fëmijës përmes kërkesës së detyrueshme që subjektet aplikuese të disponojnë politika, procedura dhe trajnime për mbrojtjen e fëmijës, verifikim të integritetit të stafit (përfshirë kontrollin e figurës për punë me fëmijë) dhe mjedise dhe praktika të sigurta;
- përcaktimi i procedurave transparente të përfshirjes (thirrje për shprehje interesi, procedura të përzgjedhjes konkurruese, verifikim në terren, marrëveshje bashkëpunimi ose kontrata), duke garantuar parimet e transparencës, konkurrencës, mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë;
- forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional dhe partneritetit publik-privat në sistemin e kujdesit alternativ në familje, duke krijuar një hapësirë të rregulluar për kontributin e sektorit jopublik;
- garantimi i mekanizmit të vazhdueshëm të monitorimit, raportimit dhe llogaridhënies për të gjitha subjektet jopublike të përfshira në ofrimin e shërbimeve.

## **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Ky projektvendim është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve të Këshillit të Ministrave për vitin 2026, në kuadër të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të Ligjit nr. 92/2025 “Për kujdesin alternativ në familje në Republikën e Shqipërisë”.

Projektvendimi propozohet në funksion të zbatimit të drejtpërdrejtë të dispozitave të Ligjit nr. 92/2025, konkretisht në zbatim të nenit 26, pika 3, që përcakton detyrimin e Këshillit të Ministrave për miratimin e kriterëve dhe procedurave të përfshirjes së organizatave të shoqërisë civile në ofrimin e shërbimeve të kujdesit alternativ në familje.

Projektvendimi mbështet zbatimin e prioriteteve të Programit të Qeverisë në fushën e mbrojtjes sociale dhe të drejtave të fëmijës, veçanërisht në drejtim të dezinstitutionalizimit të kujdesit për fëmijët pa kujdes prindëror, zhvillimit të rjetit kombëtar të familjeve kujdestare dhe forcimit të partneritetit publik-privat në ofrimin e shërbimeve shoqërore. Projektakti është i harmonizuar me:

- angazhimet e Republikës së Shqipërisë në kuadër të instrumenteve ndërkombëtare të ratifikuara, përfshirë Konventën e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës (KDF), Konventën Europiane për Ushtrimin e të Drejtave të Fëmijës të Këshillit të Evropës, dhe Udhëzimet e OKB-së për Kujdesin Alternativ ndaj Fëmijëve (Rezoluta A/RES/64/142,

2009), të cilat promovojnë rolin aktiv të organizatave të shoqërisë civile në ofrimin dhe mbështetjen e shërbimeve të kujdesit alternativ;

- detyrimet e procesit të integritetit evropian, veçanërisht në kuadër të Kapitullit 19 të acquis-it për Politikën Sociale dhe Punësimin dhe Kapitullit 23 për Gjyqësorin dhe të Drejtat Themelore;
- Agjendën Kombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës 2021–2026, miratuar me VKM Nr. 659, datë 3.11.2021, e cila parashikon zhvillimin e modelit gjithëpërfshirës të kujdesit alternativ në familje dhe dezinstitutionalizimin progresiv;
- Strategjinë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024–2030, miratuar me VKM Nr. 152, datë 13.3.2024, që vendos partneritetin publik-privat si shtyllë të reformës së shërbimeve sociale;
- Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin e Shoqërisë Civile dhe dokumentet shtetërore për nxitjen e bashkëpunimit me organizatat jofitimprurëse në fushën sociale.

### **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Miratimi i projektvendimit është i nevojshëm për të garantuar zbatimin e plotë të Ligjit nr. 92/2025 në pjesën që rregullon rolin e sektorit jopublik në kujdesin alternativ në familje. Pa një kuadër rregullator të qartë, mundësia e përfshirjes së organizatave të shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë do të mbetet e pakonkretizuar, duke kufizuar kapacitetet e sistemit dhe zhvillimin e rrjetit kombëtar të familjeve kujdestare. Aktualisht, mungesa e procedurave të standardizuara krijon praktika jo uniforme mes njësisve të vetëqeverisjes vendore, pasiguri për subjektet e interesuara dhe rrezik për cilësinë e shërbimeve të ofruara.

Për këtë qëllim, projektvendimi përcakton përbërësit kryesorë rregullatorë, duke përfshirë:

- përcaktimin e qartë të katër fushave kryesore të përfshirjes, duke përfshirë mbështetjen për identifikim, promovim dhe ndërgjegjësim; mbështetjen për rekrutimin, përgatitjen dhe shërbimet për fëmijët dhe familjet kujdestare; ofrimin e trajnimeve dhe mbështetjes së vazhdueshme;
- një kornizë gjithëpërfshirëse të kriterëve të vlerësimit në pesë kategori, kriteret ligjore dhe administrative, profesionale dhe teknike, organizative dhe të menaxhimit, financiare dhe të qëndrueshmërisë, dhe të integritetit dhe sigurisë, me kërkesa konkrete dhe të dokumentueshme për secilën kategori;
- procedura të hollësishme të përfshirjes përmes tre instrumenteve kryesore: marrëveshjeve të bashkëpunimit me njësitë e vetëqeverisjes vendore, kontraktimit për ofrimin e shërbimeve shoqërore në përputhje me legjislacionin për shërbimet shoqërore, si dhe përfshirjes në mekanizmat ndërinstitucionalë në nivel vendor;
- ndarjen e qartë të roleve dhe përgjegjësisve ndërmjet ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale, Shërbimit Social Shtetëror dhe njësisve të vetëqeverisjes vendore, duke garantuar koordinim efektiv në nivel kombëtar dhe vendor;

- një sistem objektiv pikëzimi me 100 pikë i shoqëruar me formularin e detajuar të vlerësimit (Shtojca 1 e projektvendimit), që siguron transparencë, krahasueshmëri dhe parashikueshmëri të procesit të vlerësimit;

Efektet e pritshme nga miratimi i projektvendimit janë pozitive dhe substanciale, pasi krijohet një kuadër rregullator që mundëson:

- zhvillimin e qëndrueshëm të rrjetit kombëtar të ofruesve të shërbimeve të kujdesit alternativ në familje, duke shfrytëzuar kapacitetet dhe ekspertizën e organizatave të shoqërisë civile;
- rritjen e cilësisë së shërbimeve mbështetëse për familjet kujdestare dhe fëmijët e vendosur në kujdes alternativ, përmes pjesëmarrjes së ofruesve me përvojë dhe specializim;
- garantimin e mbrojtjes së fëmijës si parim absolut, përmes kërkesave të rrepta të integritetit, sigurisë dhe verifikimit të figurës së stafit që punon me fëmijë;

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektvendimi është hartuar në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 26, pika 3, të Ligjit nr. 92/2025 “Për kujdesin alternativ në familje në Republikën e Shqipërisë”. Projektakti është në përputhje të plotë me parimet kushtetuese të mbrojtjes së veçantë të fëmijëve (neni 54 i Kushtetutës), të barazisë dhe mosdiskriminimit (neni 18) dhe të lirisë së veprimtarisë ekonomike (neni 11), dhe synon zbatimin e parimit themelor të interesit më të lartë të fëmijës të sanksionuar në Konventën e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës.

Projektvendimi është gjithashtu në harmoni me legjislacionin e brendshëm përkatës, përfshirë:

- Ligjin nr. 92/2025 “Për kujdesin alternativ në familje në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligjin nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, të ndryshuar;
- Ligjin nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- Ligjin nr. 8788/2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, të ndryshuar;
- Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar;
- Ligjin nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të korrigjuar;
- Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar;
- Ligjin nr. 9131/2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike” dhe legjislacionin për konfliktin e interesit.

Në planin ndërkombëtar, projektvendimi mbështet zbatimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Fëmijës (KDF), ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin nr. 7531/1991; Konventës Europiane për Ushtrimin e të Drejtave të Fëmijës (Strasburg, 1996); Udhëzimeve të OKB-së për Kujdesin Alternativ ndaj Fëmijëve (Rezoluta A/RES/64/142 e Asamblesë së

Përgjithshme, 2009), të cilat nxisin angazhimin e shoqërisë civile dhe organizatave jopubliket në ofrimin e shërbimeve të kujdesit alternativ; Rekomandimit Rec(2005)5 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës “Për të drejtat e fëmijëve që jetojnë në institucione të kujdesit rezidencial”; Strategjisë së Këshillit të Europës për të Drejtat e Fëmijës 2022–2027; si dhe Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm 2030 të OKB-së, veçanërisht Objektivit 16.2 për ndalimin e abuzimit, shfrytëzimit dhe dhunës ndaj fëmijëve.

## V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE

Projektvendimi në vetvete nuk synon përafrim të drejtpërdrejtë me një akt specifik të acquis-it të Bashkimit Europian, por kontribuon në mënyrë substanciale në forcimin e standardeve të mbrojtjes së fëmijëve dhe të zhvillimit të bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile, në shërbimet sociale në Republikën e Shqipërisë. Përfshirja e rregulluar dhe transparente e organizatave të shoqërisë civile në ofrimin e shërbimeve shoqërore përbën një standard të konsoliduar në praktikën e shumicës së vendeve anëtare të BE-së.

Përkatesisht, projektvendimi kontribuon në zbatimin e:

- Strategjisë së BE-së për të Drejtat e Fëmijës (2021–2024) dhe vazhdimësisë së saj, që vendos kujdesin alternativ në familje dhe pjesëmarrjen e shoqërisë civile si prioritet horizontale;
- Strategjisë së Këshillit të Evropës për të Drejtat e Fëmijës (2022–2027) dhe vazhdimësisë së saj, që promovon partneritetin me organizatat e shoqërisë civile për mbrojtjen e fëmijëve;
- Pilarit Europian të të Drejtave Sociale, që përcakton mbështetjen për familjet vulnerabël dhe fëmijët si prioritet të politikave sociale evropiane;
- Garancisë Evropiane për Fëmijët (Council Recommendation (EU) 2021/1004), e cila promovon shërbime cilësore për fëmijët vulnerabël përmes bashkëpunimit publik-privat;
- Kapitullit 19 të acquis-it për Politikën Sociale dhe Punësimin, veçanërisht pjesa që ka të bëjë me shërbimet sociale dhe rolin e sektorit jofitimprurës;
- Kapitullit 23 të acquis-it për Gjqësorin dhe të Drejtat Themelore, në pjesën që mbulon mbrojtjen e të drejtave të fëmijës;
- Direktivës 2014/24/BE për prokurimin publik, veçanërisht në pjesën që rregullon prokurimin e shërbimeve sociale dhe prokurimet e rezervuara për organizata pa qëllim fitimi (Neni 77).

Vlen të theksohet se zhvillimi i një kuadri ligjor për bashkëpunimin dhe partneritetin me organizatat e shoqërisë civile në fushën e mbrojtjes së fëmijës dhe kujdesit alternativ përbën një praktikë të konsoliduar evropiane dhe Republika e Shqipërisë, përmes këtij projektvendimi përparon dukshëm drejt arritjes së këtij standardi.

## VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi përcakton kriteret dhe procedurat e përfshirjes së organizatave të shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë në ofrimin e shërbimeve të kujdesit alternativ në familje, dhe është strukturuar në gjashtë nene të numëruara, të shoqëruara me Shtojcën 1, me përmbajtjen e mëposhtme:

### Neni 1 – Qëllimi

Përcakton qëllimin e vendimit: rregullimin e kriterëve, procedurave dhe mënyrës së përfshirjes së organizatave të shoqërisë civile në mbështetjen e shërbimeve të kujdesit alternativ në familje, me fokus te cilësia e shërbimit dhe interesi më i lartë i fëmijës.

### Neni 2 – Fushat e përfshirjes së OSHC-ve

Parashikon fushat ku mund të angazhohen organizatat e shoqërisë civile, si: identifikimi i fëmijëve dhe familjeve në nevojë, ndërgjegjësimi për kujdesin alternativ, mbështetja e bashkive në rekrutimin dhe përgatitjen e familjeve kujdestare, trajnimi dhe mbështetja e tyre.

### Neni 3 – Kriteret për përfshirjen e organizatave të shoqërisë civile

Përcakton kriteret, që duhet të plotësojnë OSHC-të për t'u përfshirë në këtë proces. Kriteret përfshijnë aspektet ligjore, administrative, profesionale, teknike, organizative, financiare, të integritetit dhe sigurisë. Gjithashtu parashikohet që vlerësimi i tyre bëhet nga një komision i ngritur nga bashkia.

### Neni 4 – Procedurat e përfshirjes

Rregullon mënyrën se si OSHC-të përfshihen në sistemin e kujdesit alternativ në familje, kryesisht përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit me bashkitë. Neni përcakton edhe përgjegjësitë e njësive të vetëqeverisjes vendore për organizimin, administrimin, vlerësimin, përzgjedhjen dhe mbikëqyrjen e bashkëpunimit me organizatat.

### Neni 5 – Roli i strukturave përgjegjëse

Përcakton rolet e institucioneve përgjegjëse në zbatimin e vendimit. Ministria përgjegjëse për çështjet sociale udhëzimet sipas nevojës, si dhe dhe siguron koordinimin në nivel kombëtar dhe harmonizimin e praktikave, Shërbimi Social Shtetëror ofron mbështetje teknike dhe monitoron cilësinë, ndërsa bashkitë organizojnë procesin, lidhin marrëveshjet, koordinojnë aktorët vendorë dhe mbajnë regjistrin e organizatave të përfshira.

### Neni 6 – Hyrja në fuqi

Parashikon se vendimi hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Vendimit i bashkëlidhet, si pjesë përbërëse e pandashme, edhe shtojca nr. 1, Formulari i vlerësimit të kërkesave të organizatave jofitimprurëse dhe aktorëve të tjerë, e cila përcakton kriteret, dokumentacionin provues dhe sistemin e pikëzimit me 100 pikë për vlerësimin e kërkesave; përfshin formularët e vlerësimit të detajuar sipas pesë kategorive të kriterëve,

klasifikimin e kërkesës, procedurat e verifikimit në terren dhe modelin e procesverbalit të komisionit të vlerësimit.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT**

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:

- Ministria përgjegjëse për çështjet sociale, për koordinimin politik, harmonizimin e praktikave në nivel kombëtar dhe monitorimin e zbatimit;
- Shërbimi Social Shtetëror dhe drejtoritë e tij rajonale, për mbështetjen teknike të njëjësive të vetëqeverisjes vendore, monitorimin e cilësisë së shërbimeve, mbajtjen dhe administrimin e regjistrit kombëtar të organizatave të përfshira dhe raportimin periodik;
- Njësitë e vetëqeverisjes vendore (bashkitë), përmes drejtorive të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe njëjësive për mbrojtjen e fëmijëve, për organizimin dhe administrimin e procesit të përfshirjes, lidhjen e marrëveshjeve dhe kontratave, mbikëqyrjen e zbatimit dhe raportimin;

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Projektvendimi është përgatitur nga drejtoria përgjegjëse për politikën e kujdesit shoqëror në ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale, në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror dhe Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (ASHDMF), në kuadër të zbatimit të Ligjit nr. 92/2025 “Për kujdesin alternativ në familje në Republikën e Shqipërisë”.

Ky projektvendim dërgohet për mendime institucioneve të mëposhtme: Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministrin e Shtetit për Pushtetin Vendor, Ministrin e Shtetit dhe Kryenegociatorit, Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile dhe Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Projektvendimi i propozuar nuk sjell efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit,

### **PROPOZUESI**

**MINISTRI I SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE**

**EVIS SALA**

